

Procesverbal

I hartuar më 19.05.2021 në debatin me banorë ne fshatin Gllamnik, ku ishin të ftuare edhe banoret e fshatrave Siboc i Poshtëm, Siboc i Epërm, Godishnjak, Penuhë, Kunushec dhe Buricë .

Temë diskutimi ishte; Propozim Rregullorja per organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Podujevës.

Drejtori i Administratës në komunën e Podujevës Bahri Selimi i cili edhe u drejtoi debatin, i informoi të pranishmit mbi të gjitha procedurat e kësaj propozim rregulloreje, e cila është hartuar në bazë te Udhëzimit Administrativ nr.02/2019 mbi organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane.

Në bazë të këti udhëzimi administrativ komuna e Podujevës duhet ti formoi 30 këshilla lokale. Me propozim rregulloren komunale është paraparë që 24 këshilla lokale të formohen nëpër fshatra dhe 6 ne qytet. Këto janë vetëm propozime dhe pas debateve dhe propozimeve dhe kërkesave banorëve mund të ndryshohen.

I vetmi fshat që është propozuar të këtë këshillin e vetëm është Gllamniku, pasi që fshati është fshati ma i madhe me banorë në komunën e Podujevës.

Kjo propozim rregullore qysh ne vitin 2020 ka dal ne diskutim publik por për shkak pandemisë kovid 19 është shtyrë, po ashtu edhe ne vitin 2021 nga asambleja komuna është shtyrë për një kohe ma te përshtatshme. Në mbledhjen e fundit asambleja komunale e ka qit në diskutim publik.

Shefki Kosumi –Gllamnik kërkoi që rregullorja të shpërndahet dhe informohen banorët me përbajtjen e kësaj rregulloreje.

Osman Bahtiri – tha edhe për kundër që fshati Gllamnik qenka propozuar një këshill lokal, ne çdo here kemi bashkëpunua me fshatrat përreth. Pati vërejtje se numri i këshillave lokale në komunën e Podujevës është shumë i vogël ne krahasim me numrin e fshatrave dhe numrin e banorëve. Pyeti edhe për mënyrën e zgjedhjes së këshillave lokale.

Bahri Selimi- pajtohem se numri i këshillave lokale në komunën e Podujevës është shumë i vogële por udhëzimi administrativë na ka obligua me shkua me këtë numër të këshillave lokale, si kriter është marr numri i banorëve. Sa i përket përfshirjen e fshatrave në një këshill aty ka mundësi me bërë ndryshime.

Osman Bahtiri propozoi që të gjitha kryetarët e këshillave të paguhen nga komuna.

Fahrudin Mahmuti Siboc i Epërm tha se këshillat e fshatrave duhet të jenë jo partiak . Me rendësi ashtë se sa do te jenë funksional këta këshilla, a ka mëndu ministria se si do te funksionojnë këto këshilla. Puna e kryetarit te fshatit është shume e madhe, duhet shume angazhim dhe kohe. Në fshatin tonë kemi që nuk kanë energji elektrike, është obligim i kryetarit te fshatit që të angazhohet për këtë çyshtje dhe për shume të tjera.

Bahri Selmi tha se të gjitha vërejtjet dhe propozimet për këtë rregullore do të përcillen ne ministri.

Osman Bahtiri tha se propozimet e këshillave të fshatrave duhet të mëren parasysh, kërkesat të shqyrtohen ne afat sa ma të shkurt, për ndarjen e subvacioneve te pyetet edhe këshilli i fshatit sepse e din gjendjen shume ma mirë se komisioni komunal.

Esat Ejupi pati vërejtjen ne udhëzuesin administrativ sepse ne vend te decentralizimit po ndodh e kundërtë. Përfaqësuesit e fshatrave nuk po njoftohen me projektet ne fshatrat e tyre. Në këshillat e fshatrave duhet të zgjidhen njerëz të ri që kanë vullnet të punojnë. Në këshillat lokale duhet të përfshihen të gjitha fshatrat dhe lagjet.

Bahri Selimi tha i kuptoi se nuk do të jetë e lehtë formimi i këshillave lokale, duke pas parasysh numrin e madh të fshatrave dhe pozitën gjeografike te komunës së Podujevës.

Do të kërkoi takim me ministrin e pushtetit lokale, do të ia paraqes të gjitha kërkesat e komunitete neper këto debate dhe do te kërkoj nga ministri ndryshimin e udhëzimet administrativ.

Gllamnik, më 19.05.2021

Procesmbajtësi

Latif Mehmeti